

Fatmir Caca: Cdo ndeshje eshte si finale

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 28 Nentor 2013 02:29



Ndeshja Kastrioti – Bylis, konsiderohet si nje nga ndeshjet me interesante te javes se 12-te. Dy humbjet e pesuara rrradhazi kane renduar disi situaten tek kampi krutan, te cilet ne ndeshjen ndaj ballashioleve kerkojne me cdo kush marrjen e tre pikeve. “Do te jete nje ndeshje qe do te luftojme te marrim tre piket. Nuk ka rruge tjeter per ne, pasi ne te kunderten, rrezikojme daljen nga kategoria. Si ndeshja ndaj Bylis ashtu dhe ndeshjet e tjera do ti konsiderojme si ndeshje finale”, u shpreh kapiteni i Kastriotit, 27 vjecari, Fatmir Caca. Ne ndeshjen e kesaj jave formacioni krutan, do te jete i plote. Pritet qe shkallet e stadiumit te jene me shume sportdashes. Statistikat e viteve te fundit flasin per nje superioritet te skuadres krutane, te cilet ne pese ndeshjet e fundit kane fituar tre , barazuar nje dhe humbur nje.